

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës**, me objekt: *“Për zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve”,* lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”,* për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 151, datë 10.11.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”,* me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 381/12, datë 10.11.2014, i ka rekomanduar z. Jurgis Çurbja, Regjistrues i ZVRPP Durrës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: ZVRPP ka zbatuar pjesërisht rekomandimet e dërguara nga KLSH në auditimin e mëparshëm, në kundërshtim me urdhrin e Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006 *“Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të ministrive, trajtuar “më hollësisht në faqen.15-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1. Rekomandimi: ZVRPP të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pazbatuara, të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 382/20, datë 20.4.2012, protokolluar në ZVRPP Durrës me nr. 1774 datë 23.4.2012. dhe t’i kërkohej KVTP verifikimi i titujve të pronësisë në bazë të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 *“Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, neni 1 dhe neni 9.*

Brenda datës 31.12.2014

2.Gjetje nga auditimi: Zona Kadastrale 3365 SHETAJ Durrës.

Gjetje: Nga auditimi i 118 AMTP të plotësuar nga komisionet e ndarjes së tokës të fshatit Shetaj rezultoi se për 40 raste janë dhënë **91,609 m² tokë arë më tepër** duke krahasuar sipërfaqet e regjistruara sipas dokumentit ligjor (Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi) me sipërfaqet të azhurnimit fushor të printimit të tretë të kryer nga Njësia e Menaxhimit të hedhura në kartela në muajin shtator 1999 (LN), sipas tabelës trajtuar në procesverbalin nr. 6, datë 09.05.2014, në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”,* të ndryshuar, neni 25, rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 *“Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”,* me ndryshime.

2.1 Rekomandim: ZVRPP Durrës të marrë masa për **kufizimin e sipërfaqeve prej 91,609 m²** të regjistruara sipas LN më tepër se dokumenti ligjor sipas pasqyrës **Aneksi nr.10) bashkëlidhur Raportit përfundimtar të Auditimit** që përmban listën emërore të përfituesve, sipërfaqen, nr. pasurie dhe volum faqe të regjistruar në ZK 3365, fshati Shetaj, komuna Ishëm.

- ZVRPP Durrës të njoftojë përfituesit e sipërfaqeve më tepër dhe të kryejë kufizimin e veprimeve për pasuritë në zbatim të kërkesave të Ligjit 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, nenet 59, 60 dhe 74 me afat deri në kryerjen e regjistrimit të sipërfaqeve pasuri shtet.

Brenda datës 31.12.20143

ZK 3365 Shetaj Durrës Rurale për 7 pasuri me AMTP të dyta pas vitit 2000 trajtuar në f 45-55 të Raportit Përfundimtar të auditimit.

Gjetje: Gjatë auditimit rezulton se për vitet 2011- 2013 në ZVRPP Durrës, në ZK. 3365 Shetaj, janë kryer regjistrime fillestare dhe lëshuar certifikata pronësie për 9 raste pasuri bujqësore me sipërfaqe **prej 68201 m²**, me dokumente kryesisht AMTP të dyta të plotësuar dhe të miratuara nga komuna Ishëm si dhe në disa raste nga përfaqësuesi i Këshillit të Qarkut Durrës, akte këto shitesë mbi sipërfaqet e përfituara me aktet e përbërjes gjendje familjare 01.8.1991. Për këto akte nuk është kërkuar verifikimi i vlefshmërisë së tyre nga Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durrës (KVVTP) në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 1, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin” dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre. Gjithashtu nuk është bërë verifikimi i të gjitha akteve të marrjes së tokës në pronësi në fshatrat përkatëse, mbasi rezulton se ka përfitues që janë mbi normë për frymë, domethënë kanë marrë tokë më tepër nga sa duhet të merrnin në momentin e ndarjes së tokës sipas kriterëve të vendosura nga ligji 7501, datë 01.08.1991, dhe regjistrimi i tyre bie në kundërshtim ligjin Nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 të ZQRPP “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

3.1 Rekomandim: ZVRPP Durrës të marrë masa për kufizimin e sipërfaqeve prej 91201 m², për pasuritë sipas tabelës “AMTP të Dyta të plotësuar pas vitit 2000, për banorët e ZK nr. 3365, fshati Shetaj në zbatim të kërkesave të Ligjit 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, nenet 59, 60 dhe 74 me afat deri në marrjen e vendimit nga KVVTP, pranë Prefekturës Durrës.

Brenda datës 31.12.2014.

4. ZK 2574 Rurale-Urbane SZ Xhafzotaj

Gjetje: Në ZK 2574 Xhafzotaj në 29 raste kartelat Pasurive të paluajtshme të mbyllura nuk rezultuan të vulosura dhe të nënshkruara nga regjistruarit dhe pse vijojnë në volum e faqe.

Në një rast u konstatua regjistrimi dhe certifikimi i pasurive nr. 158/293 dhe 158/295 në pronësi të shtetasit A.M. **me ndryshim të zërit kadastral nga truall në “arë” për sipërfaqen 2355 m².**

Në një rast u konstatua të jetë regjistruar pasuri e përfituar nga ligji i urbanistikës me leje ndërtimi “Objekt Magazinë” me sipërfaqe 4907 m² dhe në praktikën e regjistrimit mungon Studimi Urbanistik Pjesor i sheshit të ndërtimit për ndryshimin e zërit kadastral nga arë në truall, mbasi në këtë zonë boniteti i tokës është kategoria dytë.. Nuk ka miratim për ndryshimin e zërit kadastral nga Ministria e Bujqësisë dhe KRRTRSH, në kundërtim ligjin Nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 të ZQRPP “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

4.1 Rekomandim: Nga ZVRPP Durrës të merren masa për kufizimin e veprimeve për pasuritë nr. 158/293 dhe 158/295, dhe miratimin e ndryshimit të zërit kadastral nga ullishte në truall për magazinën e ndërtuar në ZK nr. 2574, fshati S Z Xhafzotaj, në zbatim të kërkesave të Ligjit 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, nenet 59, 60 dhe 74 me afat deri në marrjen e vendimit nga KVVTP, pranë Prefekturës Durrës.

Brenda datës 31.12.2014

5.ZK 1204 Rurale Bizë Durrës

Gjetje: Gjatë auditimit rezulton se në një rast në ZK 1204, fshati Bizë, komuna Ishëm është bërë regjistrimi fillestar i një sipërfaqeje prej 10500 m², në emër të A.A. në zërin kadastral “arë”, sipas AMTP nr. 79/1, datë 12.02.2002. Në volum 6, faqe 121 pasuria nr. 445/70 ekziston në zërin kadastral “P F” (tokë e pa frytshme), ndryshimi i zërit kadastral nga “PF” në “arë” është bërë pa dokumentacionin e strukturave kompetente si Këshilli i Qarkut apo MBUMK pa Vendim të Këshillit të Ministrave, pra mungojnë procedurat për ndryshimin e sipërfaqes prej 10,500 m² për parcelën nr. 73, në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, me ligjin nr. 8752, datë 28.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10210, datë 25.03.2010 si dhe me Kreun III “Procedurat për ndryshimin e kategorive të Resurseve” të VKM Nr. 532, datë 31.10.2002 “Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes të Tokës në qark dhe në zyrat e Menaxhimit të Mbrojtjes së tokës Komuna e Bashki.

5.1 Rekomandim: ZVRPP Durrës të marrë masa për kufizimin e sipërfaqes prej 10500 m² për ndryshimin e zërit kadastral nga PF në arë, në ZK nr. 1204, fshati Bizë në zbatim të kërkesave të ligjit 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, nenet 59, 60 dhe 74 me afat deri në marrjen e vendimit nga KVVTP, pranë Prefekturës Durrës..

6. ZK 3385 Shkallnur Durrës.

Gjetje: Është konstatuar nga auditimi se në ZK 3385 Shkallnur Durrës, në një rast është regjistruar në volum 13, faqe 168 Pasuria nr. 578/174 një objekt “godinë banimi e shërbimi $8 + \frac{1}{2} + 1$ kat shërbime + 1 kat garazh + papafingo”, sipas vendimit të KRRT-së me sipërfaqe ndërtimore 680 m^2 , ndërsa sipërfaqja sipas aktkollaudimit dhe regjistrimit është $751,64 \text{ m}^2$, më tepër për $71,64 \text{ m}^2$ në kuotën 0:00 dhe për rrjedhojë për gjithë sipërfaqen e regjistruar $542,32 \text{ m}^2$.

Për sa trajtuar me lart del një mos përputhja del 542.3 m^2 ndërmjet lejes së sheshit të ndërtimit me veprimet e regjistrimit në ZVRPP Durrës. Gjithashtu nuk ka asnjë vendim për khimin e kësaj sipërfaqen prej 3725 m^2 nga ullishte në truall, veprime këto pa saktësim të dokumentacionit përbën shkelje të nenit 24/a të ligjit Nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 të ZQRPP “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

6.1 Rekomandim: ZVRPP Durrës të marrë masa për kufizimin e sipërfaqes objekt “godinë banimi e shërbimi $8 + \frac{1}{2} + 1$ kat garazh + papafingo”, më tepër për $71,64 \text{ m}^2$ në kuotën 0:00 dhe llogaritje për gjithë sipërfaqen e regjistruar $542,32 \text{ m}^2$, në fshatin Shkallnur, në zbatim të kërkesave të Ligjit 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, nenet 59, 60 dhe 74 me afat deri në plotësimin e praktikës me dokumentacionin ligjor.

Brenda datës 31.12.2014

7. ZK 8518 Urbane Plazh Durrës

Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar se në Përfaqësuesi i Kompanisë “Ute-Tracasa-Inypsa” Regjistrimi Fillestar ka përfunduar me datë 28.11.2012 në ZK 8518 Plazh Durrës dhe dorëzimi i produktit sipas shkresës nr. 526, datë 06.05.2013, protokolluar në ZVRPP me nr. 2817, datë 07.05.2013.

Nga auditimi i volumit 100 të ZK 8518 rezultoi se nga faqe 2 deri 125 del se ka qenë volum 89 të plotësuar faqet 39 deri 162 të cilat janë lakuar me vizë të kuqe duke u vendosur numurat korespondues të volumit 100 faqe 2 deri 125. Në lidhje me këtë korigjim nuk na u vu në dispozicion urdhër regjistruesi që të evidentohet ky fenomen në momentin e marrjes së zonës në dorëzim të produktit.

Në përfundim puna e kryer nga Kompania “Ute-Tracasa-Inypsa” në lidhje me Regjistrimin Fillestar të kësaj Zone Kadastrale nuk është printuar sipas formatit të kërkuar, por është mjaftuar me korigjimin e bërë në volum 100, faqe respektive dhe për veprimet sporadike të kryera nga zyra gjatë periudhës së punës. Si konkluzion nga ana e zyrës nuk duhet të merreshin në dorëzim këto volume me korigjime si volum dhe faqe dhe të pa printuara.

Në dy raste dërgimi i dokumentacionit ligjor për leje përdorimi ndërtimi pallate rezultoi:

- për regjistrimin fillestar të pasurisë nr. 4/24-nd, Plazh Durrës për objekt “rikondicionim, freskim sheshi për objekt i shkallëzuar 4, 5, 7, 8 kate banim shërbim hoteleri”, me sipërfaqe sheshi ndërtimi 2000 m², sipërfaqe ndërtimore 848 m², nga ana e specialistëve të zyrës bazuar në akt kolaudimit ka regjistruar 860 m², më tepër 12 m². Gjithashtu po sipas akt kolaudimit nuk ka regjistruar sipërfaqet e përbashkëta për Seksionin “A” 34,7 m², Seksionin “B” 34,7 m², dhe Seksionin “C” 35 m², pra në total 104,4 m², duke ju shmangur detyrimeve tatimore për rastet e shitjeve.

-Me referencë nr. 21047, për regjistrimin fillestar të pasurisë nr. 44/92, Plazh Durrës për objekt “godinë banimi dhe njësi tregtare 6 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë me funksion garazh”, me sip. sheshi ndërtimi 400 m², sipërfaqe ndërtimore 268.8 m²,

Ky objekt është regjistruar në volum 100, faqe 182, në Seksionin “B” të kartelës lloji i pasurisë pallat 268.8 m² nga kjo 268.8 m² truall, ndërsa në Seksionin “C” shënuar. Gjithashtu nisur nga vendimi i lejes së sheshit të ndërtimit për këtë objekt është miratuar sipërfaqja e sheshit 268.8 m², ndërsa në kuotën 0:00 është zbatuar 308.8 m² si konkluzion del një mospërputhje leje sheshi me zbatimin prej 40 m² dhe për 6 kate ndërtimi mbi tokë rezulton sipërfaqja prej 240 m².

Për sa trajtuar me lart mos përputhja del 905.77 m² ndërmjet lejes së sheshit të ndërtimit me veprimet e regjistrimit në ZVRPP Durrës, për rrjedhojë regjistrimi pa saktësim të dokumentacionit përbën shkelje të nenit 24/a të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të paluajtshme” i ndryshuar dhe rregullores së brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999.

7.1 Rekomandim: ZVRPP Durrës të marrë masa për kufizimin e veprimeve në ZK nr. 8518, Plazh Durrës për pasuritë nr. 4/24-nd, Plazh Durrës për objekt “rikondicionim, freskim sheshi objekt i shkallëzuar 4, 5, 7, 8 kate banim shërbim hoteleri” regjistruar në volum 89, faqe 67 për sipërfaqen 116.4 m² më tepër të rezultuara në kuotën 0:00 dhe pasuria nr. 44/92, Plazh Durrës objekt “godinë banimi dhe njësi tregtare 6 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë me funksion garazh”, regjistruar në volum 100, faqe 182 për sipërfaqen 40 m² më tepër në kuotën 0:00, në zbatim të kërkesave të Ligjit 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, nenet 59, 60 dhe 74 me afat deri në plotësimin e praktikës me dokumentacionin ligjor.

Brenda datës 31.12.2014

8.Për Institucionet e tjera:

Rekomandime: T’i kërkohet Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Durrës (KVVTP) të verifikojë titujt e pronësisë sipas Pasqyrave anekse 1 dhe 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 1, datë 13.01.2010 në lidhje me proedurat e regjistrimit fillestar të pasurive, për AMTP të dyta të plotësuar mbas vitit 2000, regjistruar në ZK 3385, fshati Shetaj, sipërfaqja prej 91201 m², dhe ZK 1204, fshati Bizë me sipërfaqe 10500 m², komuna Ishëm.

Brenda datës 31.12.2014

9. Gjetje nga auditimi: Zona kadastrale 2375 fshati Lalëz, Komuna Ishëm.

Për zonën kadastrale 2375 Lalëz nuk rezulton të jenë përpiluar listat e printimit të tretë AMTP- LN.

U audituan me zgjedhje **138 pasuri, për 88 subjekte nga të cilat me regjistrim fillestar 30 subjekte dhe me AMTP –LN 58 subjekte.**

Regjistrimi i pasurive të përfituara nga ligji 7501, datë 19.07.1991 në ZK 2375. Lalëz Komuna Ishëm, për 58 subjekte rezulton të jenë përfitur nga banorët pasuritë sipas LN dhe jo sipas AMTP, si dokumentacion ligjor me një sipërfaqe **më tepër 81618 m², pa u veçuar më parë pasuria shtet, në kundërshtim me nenin 25 a dhe 38 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të paluajtshme”**

UKM nr. 1, datë 31.01.2007 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe udhëzimin nr. 2, datë 08.04.2009.

Për këto pasuri janë dhënë certifikata pronësie në periudha të ndryshme nga viti 2000 deri në vitin 2010 duke pajisur me certifikata pronësie banorët në bazë të dhënave të LN, që janë më të mëdha se dokumentacioni i ligjshëm i pronësisë AMTP. .

Gjatë auditimit të dokumentacionit të regjistruar u konstatua të jetë regjistruar truell sipas AMTP-ve (AMTP 6,40,49,60,63, dhe 67) **më tepër 1942 m².**, ndërsa sipas akteve(8,48,60,195,164, dhe 124), janë regjistruar regjistruar në KPP sipërfaqe toke bujqësore **më tepër se akti 4108 m²**, gjithashtu janë regjistruar AMTP me **korigjime e shtesa në 24 raste.** (AMTP 8, 12, 6, 11, 19, 28, 34, 38, 39, 44, 50, 60, 61, 63, 66, 81, 84, 37, 62, 49, 122, 182, 128 dhe 182/4). Për këto pasuri të evidentuara **për 58 subjekte, në 13 raste** janë kryer transaksione pa u veçuar më parë pasuria shtet dhe shitjet e pasurive janë kryer sipas LN dhe jo sipas AMTP. **Në 17 raste me sipërfaqe 1643 m²** janë regjistruar ndërtime pa dokumentacionin e duhur ligjor në zbatim të VKM Nr. 432, datë 14.8.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, mbasi nuk disponohet asnjë e dhënë nga Komuna në ZVRPP, si listat emërore të ish-pronarëve për pronësinë e ndërtesës dhe trojeve në zonën 2375, dokumentacioni për azhornimin e pasurisë zonën urbane, madhësia e sipërfaqes truellit në pronësi të ish-pronarit të ndërtesës sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr.7693, datë 7.4.1993 “Për urbanistikën”.

Akti 84, datë 17.01.1995 në emër të R.Gj. përveçse është me korigjime e shtesa përmban një sipërfaqe prej 34300 m², ndërsa në fakt nga mbledhja arithmetike rezulton 28300 m² **me diferencë evidentuar më tepër në akt 6000 m².** Dy pasuri në emër të H.Xh. të evidentuara në regjistra, në KPP rezultojnë të mbyllura por nuk evidentohet se ku janë bërë regjistrimet pas mbylljes së KPP në volum e faqe.

Në 3 raste sipas referencave 0756,1041 dhe 0882 nga 3 subjekte është përfitur truell sipas ligjit nr. 10186, datë 05.12.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, duke ndryshuar zërin nga tokë e pa fryt, Pyll në truall në zonë turistike, zonë e stimuluar kur këto subjekte nuk gëzojnë titullin person i stimuluar, në zonë të stimuluar për veprimtari të stimuluar, veprimtari e cila zhvillohet nga subjekti “L..” shpk, duke ju shmangur detyrimeve që rrjedhin nga regjistrimi i kontratave të shitjes nëpërmjet subjektit e cila gëzon të drejtën e personit të stimuluar , në zonë të stimuluar dhe përfitues nga ligji nr. 10186, datë 05.12.2009.

Në të gjitha rastet e tjera sipas referencave janë kryer regjistrime fillestare nga fshatrat Gjuricaj e Kërtushaj në Lalëz në parcelën nr. 134 dhe 177 me AMTP të dyta nga viti

2002 deri 2005 vetëm sipas shkresave të Komunave pa pasur konfirmin nga KQ, dhe pa pasur certifikatë të gjendjes familjare të vitit 1991, në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.04.2009

Sipas dokumentacionit të regjistrimeve fillestare me AMTP nuk përcaktohet norma për frymë dhe AMTP-të rezultojnë të jenë korrigjuara.

Me referencë 0960 -aplikim nr. 11499, nga S.A. është regjistruar pasuria 246/2 sipas AMTP 253 tokë arë 3000 m2 dhe kësaj pasurie i është ndryshuar zëri nga Ullishtë në Arë me **Urdhrin e regjistruesit nr. 2125, datë 15.08.2013.** pa informacion sqarues nga Komuna.

Me referencën nr. 0196 regjistruar pasuria në emër të B.C. pa akt, vetëm me plan rievimi nga B.S. për 3494 m2 pa nëshkrimet përkatëse, pa shkresë të shkresë të Komunës dhe pa konfirmim të KQ.

Me referencën 0038 regjistruar pasuria 177/25 Regj.Fill. sipas aktit 217, në emër të Latif Mullaj dhe ky akt është sekuestro nga prokuroria sipas p.v.29.05.2014. Kjo pasuri 177/25 sipas hartës dhe listës së dërguar nga Komuna rezulton me sipërfaqe 3062 m2, ndërkohë është regjistruar sipas aktit 5000 m2 duke spostuar këtë pasuri në pasurinë 177/26 që evidentohet arë e rrugë pa akt dhe pa emërtim sipas shkresës së Komunës, **duke përfutur më tepër 1938 m2.**

Sipas nr. Pasurisë 177/23, hartës dhe listës së Komunës E.Sh. duhet të kishte të regjistruar 1513 m2, ndërsa sipas referencës 092 rezulton të jetë regjistruar 3060 m2 , duke regjistruar **më tepër 1547 m2.**

Sipas nr. p. 177/22 hartës dhe listës së Komunës R.Sh. duhet të kishte të regjistruar 5068 m2, ndërsa sipas referencës 091 rezulton regjistruar 1515 m2, **regjistruar më pak 3553 m2 .**

Sipas nr. 177/24 hartës dhe listës së Komunës G.Y. duhet të kishte të regjistruar 3053 m2, ndërsa sipas referencës 093 rezulton regjistruar 3060 m2, **regjistruar më pak 7 m2,** ky subjekt ka certifikatë por nuk ka akt në dosje. Ky subjekt **sipas referencës 095,** ka regjistruar **pasurinë 177/24** sipas shkresës së Komunës ekstra datë 20.07.2004, nënshkruar vetë si kryetar Komune duke spostuar këtë numër në pasurinë 177/25 që i përket **L.M.** Për këtë pasuri janë plotësuar 2 akte me nr. 264. njëra me letër të hollë(fotokopj0 dhe tjetra me karton të cilat përputhen në sipërfaqe por jo në shkrime me plan rievimi.

9.1.Rekomandim: Nga ZVRPP Durrës të merren masa për kufizimin e pasurive dhe t'i kërkohet KVTP verifikimi i titujve të pronësisë në bazë të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", neni 1 dhe neni 9 sipas pasqyrës **Aneks 4.**

10. Gjetje nga auditimi: -Zona Kadastrale 1031, fshati Arapaj RASHBULL

Nga auditimi i **30 AMTP, në 18 raste** u evidentuan mangësi dhe rezulton të jetë përfutur me LN më **tepër 3168 m2** në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për Tokën", dhe janë kryer veprime pa u veçuar më parë pasuria shtet, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.06.2013 të Këshillit të Ministrave.

10.1. Rekomandim: Nga ZVRPP Durrës të merren masa për kufizimin e pasurive dhe t'i kërkohet KVTP verifikimi i titujve të pronësisë në bazë të ligjit nr. 9948, datë

07.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, neni 1 dhe neni 9.

11. Gjetje nga auditimi: Zona Kadastrale 2453, Fshati Likmetaj,

- Nga auditimi i **80 AMTP** në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”, në **14 raste** u evidentuan mangësi e shkelje në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843 datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.06.2013 të Këshillit të Ministrave, duke përfutur me LN më tepër se AMTP **31285 m²**, duke dhënë certifikata sipas LN dhe jo sipas AMTP pa u veçuar më parë pasuria shtet.

11.1. Rekomandim: Nga ZVRPP Durrës të merren masa për kufizimin e pasurive evidentuar në pasqyrën **Aneks 6** dhe zhvilluar nga f.33 deri f.35 në Raportin Përfundimtar të Auditimit. dhe t’i kërkohet KVTP verifikimi i titujve të pronësisë në bazë të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, neni 1 dhe neni 9.

12. Gjetje nga Auditimi: Zona Kadastrale 3215, Rashbull

Nga auditimi **gjithsej 30 AMTP**, të rregjistruara nga Njësia e Menaxhimit të Projektit në 7 volume, në **11 raste** u evidentuan mangësi e shkelje në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843 datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar dhe të Rregullores së ZQRPP-së.:Komisioni i ndarjes së tokës të fshatit Rashbull në muajin shkurt 1992 për familjet bujqësore ka plotësuar **110 AMTP** në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe certifikatat janë plotësuar sipas LN dhe jo sipas AMTP dhe u konstatuan diferenca 774 m² dhe ndryshim zëri në 4 raste.

12.1. Rekomandimi: Nga ZVRPP Durrës të merren masa për kufizimin e pasurive dhe t’i kërkohet KVTP verifikimi i titujve të pronësisë në bazë të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, neni 1 dhe neni 9.

13. Gjetje nga auditimi: d. Zona Kadastrale 3385, Shkallnur, Komuna Rashbull.

-Nga auditimi i dokumentacionit me zgjedhje **për 140 subjekte** u konstatua të jenë përfutur më tepër **221 637 m²**, pa u veçuar më parë pasuria shtet, në kundërshtim me nenin 25 a dhe 38 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të paluajtshme” i ndryshuar.

-Në ZVRPP Durrës nuk disponohen të dhëna në lidhje me përcaktimin e normës për frymë që përfitonin banorët e Komunës Rashbull në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 10.08.1991.

13.1 Rekomandimi: Nga ZVRPP Durrës të merren masa për kufizimin e pasurive dhe t’i kërkohet KVTP verifikimi i titujve të pronësisë në bazë të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, neni 1 dhe neni 9.

14. Gjetje nga Auditimi: në Zonën Kadastrale 3385.

Në **96 raste regjistruar troje më tepër me sipërfaqe 10225 m² për subjekte private, në kundërshtim me VKM nr. 432, datë 14.08.1995** “Për procedurat e regjistrimit sipas listës emërore të ish-pronarëve të trojeve” dhe me **Dekretin nr. 5747, datë 29.06.1978, neni 10 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave”** që sipas të cilit ndërtimi i banesave vetjake në fshatrat fushore, jepet në

përdorim një ngastër deri në 200 m², në fshatrat kodrinor e malor deri në 300 m² dhe në qytet, sipas rastit 140 m² deri në 170 m².

14.1 Rekomandimi: Nga ZVRPP Durrës të merren masa për kufizimin e pasurive evidentuar në pasqyrën **Aneks 9** dhe zhvilluar nga f. 42 deri f. 43 në Raportin Përfundimtar deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor të Auditimit. dhe t'i kërkohej KVTP verifikimi i titujve të pronësisë në bazë të ligjit nr. 9948, datë 07.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", neni 1 dhe neni 9.

15. Gjetjet nga Auditimi: Zonën Kadastrale 8512 Durrës.

-**Me referencën 11665**, aplikim 778, datë 22.04.2009, regjistruar sipërfaqe truall 400 m² dhe 219.1 m² ndërtim pa dokumentacionin e duhur ligjor të pronësisë (me leje ndërtimi, kshb, privatizim, legalizim, me vendim të KKKP ose përfituar sipas procedurave të nenit 24/b)

-**Me referencën 11733**, aplikim 450, datë 22.01.2007 regjistruar sipërfaqe truall 624 m² duke ndryshuar zërin nga Ledh në Truall. pa pasur dokumentacionin e duhur ligjor si studim të miratuar, leje ndërtimi nga organet kompetente.

-**Me referencën 11777**, aplikim 903, datë 21.06.2010, regjistruar pasuria sipërfaqe truall 130.8 m², bazuar në VKPP 178, datë 26.11.1993 që sipas të cilit i njihet vetëm e drejta e pronësisë për dy shtëpi dhe ish-dyqanin e Valutës dhe nuk evidentohet kthim truall.

5. Me referencë 11869, aplikim 719, datë 17.03.2011 regjistruar sipërfaqe trualli 172 m² që vjen ga bashkim pasurish dhe është përfituar me VKKP nr. 559, datë 22.07.1994.

Nga auditimi i dokumentacionit në dosje rezulton se kjo pasuri vjen nga pasuria me nr. 24/170, me ref. 3515 sipas pasurisë nr. 24/530, për 123.89 m² dhe pasuri shtet sipas pasurisë nr. 24/176, me sipërfaqe 48.11 m² (Bashkim Pasurish) me KKP nr. 559, datë 22.07.1994 i cili i njeh të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve të N.R. për një sipërfaqe 380 m² e lirë dhe nuk shprehet për kthim pasurie.

15.1 Rekomandimi: Meqënëse këto pasuri janë regjistruar me vendime komisioni me njohje sipas vendimeve të gjykatave por që nuk shprehen për kthim dhe i përkasin periudhës së vitit 1994 të kërkohej interpretim nga AKKP Tiranë në lidhje me regjistrimin e vendimeve me njohje të periudhës vitit 1994, zhvilluar në f.19-21 Raportit Përfundimtar të Auditimit.

16. Gjetjet nga Auditimi: -**Në ZK 3385 Shkallnur Durrës**, regjistruar një objekt "godinë banimi e shërbimi 8 + ½ + 1 kat shërbime + 1 kat garazh + papafingo", sipas vendimit të KRRT-së me sipërfaqe **ndërtimore 680 m², ndërsa sipërfaqja sipas aktkollaudimit dhe regjistrimit është 751, 64 m², më tepër për 71,64 m²** në kundërshtim me nenin nenin 24/a të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 "Për Regjistrimin e Pasurive të paluajtshme" i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999.

Zona Kadastrale 8512

- Sipas referencës nr.11709 regjistruar objekt 4 kate, por nuk ka datë të Vendimit të pa Studimin Urbanistik Pjesor të miratuar, Akt-kollaudimi i pa nëshkruar nga Mbikëqyrësi i punimeve, në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, pa ka Plan

Vendosjen të miratuar dhe dokumenta të tjera bashkëlidhur Lejes së Përdorimit që individualizojnë objektin, në kundërshtim me pikën 12 të rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 6, datë 21.01.2001 në zbatim të nenit 3 të ligjit 7843, datë 13.07.1994.

Zona Kadastrale 3385

- **Regjistrimi i objektit “Rezidencë pushimi 12 kate+Papafingo+Podrum”**, në favor të subjektit privat **“G..B” shpk** është bërë në kundërshtim me pikën 12 të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe Urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 6, datë 21.01.2001 në zbatim të nenit 3 të ligjit 7843, datë 13.07.1994.

Në dosje mungojnë Studimi Urbanistik, Leje për prerje drurësh, Oponenca Teknike, vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve, certifikata e provave laboratorike e tj. Aktkollaudimi i pa firmosur nga kollauduesi i punimeve në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit dhe Udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001.”Për mbikqyrjen dhe kollaudimintë ndërtimitt” të ndryshuar. Marrëdhëniet e pronësisë me truallin rezultojnë të pasaktësuar. *Leja e Ndërtimit është për një objekt në terren, ndërsa janë ndërtuar dy objekte 12 Kate +Papafingo+Podrum.*

- **Regjistrimi i objektit ”7 Kate +Garazh+Papafingo”**, të subjektit ndërtues, “K.. Konstruksion” është bërë në kundërshtim me pikën 12 të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe Urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 6, datë 21.01.2001 në zbatim të nenit 3 të ligjit 7843, datë 13.07.1994.

Në dosje mungon: Kontrata e sipërmarrjes së ndërtimit midis pronarëve të truallit dhe subjektit ndërtues. Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinerike për “Godinë 6 kate” (Formulari 3/1) është pa datë dhe i pa aprovuar nga zyra e urbanistikës, nuk ka mbikëqyrës punimesh, akti i kollaudimit i pa firmosur nga kollauduesi, nuk ka oponencë teknike, mungon studimi urbanistik pjesor, planvendosja e miratuar, mungon certifikata e cilësisë së materialeve të përdorura etj.

-**Regjistrimi i objektit “Godinë shërbimi 6 kate +1kat dyqane+papafingo+garazh nëntokë** i ndërtuar nga subjektit **“XH..A” shpk**, është në kundërshtim me pikën 12 të rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 dhe Urdhrit të Kryeregjistruesit nr. 6, datë 21.01.2001 në zbatim të nenit 3 të ligjit 7843, datë 13.07.1994.

Në dosje mungon: Kontrata e sipërmarrjes së ndërtimit midis pronarëve të truallit dhe subjektit ndërtues, lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinerike për “Godinë 6 kate” (Formulari 3/1) është pa datë dhe i pa miratuar nga Zyra e Urbanistikës, nuk ka mbikëqyrës punimesh, akti i kollaudimit i pa firmosur nga kollauduesi, nuk ka Oponencë Teknike, mungon Studimi Urbanistik Pjesor dhe Planvendosja e miratuar, mungon certifikata e cilësisë materialeve të përdorura etj.

Në lidhje me dokumentacionin e regjistrimit u konstatua shkelje, mospërputhja e sipërfaqeve sipas kateve gjithsej **496 m2** dhe **taksa** e ndikimit në infrastrukturë duhej të ishte llogaritur për sipërfaqen **9566 m2** sipas aktit të kollaudimit me vlerë objekti sipas çmimit entit të Banesave **277 461 830 lekë** dhe pagesa e taksës duhet të ishte llogaritur **2%** në vlerën **8 323 854.9 lekë dhe 1%** në vlerën **2 774 618 lekë**

Pagesa e taksës së ndikimit në Infrastrukturë prej 3 % rezulton 138.700 + 277510 = 416 210 lekë. Llogaritja e kësaj takse nga Komuna është bërë vetëm për sipërfaqen prej 478.4 m² me vlerë objekti 13 875 992 lekë.

Në bazë të Akt kolaudimit dhe projektit llogaritja e taksës duhet të ishte bërë për sipërfaqen totale të ndërtimit 9 566 m² x 29005 lekë/m² = 277 461 830 lek.

Në total subjekti duhet të kishte paguar 11 098 472 - 416 210 = ***10 682 262 lekë.***

16.1 Rekomandimi: Nga ZVRPP Durrës të merren Masa për kufizimin e këtyre pasurive deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në zbatim të ligjit të Urbanistikës nr. 8405, 19.07.1998 i ndryshuar.

17.Gjetje nga Auditimi: -***Me referencën 1492, ZK 8512,*** regjistruar pasuria 14/406 për 112,07 m² Volumi nr. 46, faqe 126, me certifikatë të lëshuar 03.05.2011 nënshkruar nga B.L. dhe P.B. pa dokumentacion ligjor pronësie, kontratë, nota transkriptimi, pa Deklarata noteriale të kufitarëve, pa Relacion nga Komisioni i ngritur në zbatim të procedurave sipas nenit 24/b dhe dokumente të tjerë që vërtetojnë pronësinë, për kryerjen e procedurës në zbatim të nenit 24/b sipas VKM nr. 1025, datë 09.07.2008, ***në kundërshtim me ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 i ndryshuar.***

17.1 Rekomandimi: Nga ZVRP të merren masa për kufizimin e kësaj pasurie deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor në zbatim të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurisë së Paluajtshme”.

18. Gjetje nga Auditimi: Ankesa e depozituar nga Musa Bylykbashi (trashëgimtar i protokolluar në KLSH me nr. nr. 666 prot. datë 30.06.2014.

-**Ankuesi M.B. (trashëgimtar i M.M.)** pretendues për 96 Dynym ku është bërë ndërtim nga shoqëria Tropikal nuk rezulton të ketë bërë aplikim për regjistrimin e pronës kthyer me **vendimin nr. 94, datë 20.06.2004.**

Për këtë vendim Gjykata e Shkallës Parë Tiranë, ***me vendimin nr. 6057, datë 30.05.2013 ka vendosur rrëzimin e Kerkese-Padisë*** së paditesit M.B. vendim i cili është lënë në fuqi ***me vendimin Nr. 787 të Gjykatës Apelit*** Tiranë, dhe ankuesi vazhdon të jetë në proces gjyqësor.

-Përsa i përket regjistrimit të shoqërisë Tropikal rezulton se ***me datë 25.10.1996 S.K.*** me cilësinë e përfaqësuesit të Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Shqipërisë i kalon në pronësi duke i shitur shoqërisë “T..l” shpk, ish kampin e pionierëve Durrës me objektet dhe territorin pronë e cila rezulton e regjistruar në ZVRPP Durrës me nr. 4751, datë 18.05.1994, në favor të sindikatës me një territor prej 90 000 m². Ky veprim është ***në kundërshtim me ligjin nr. 8340/1, datë 5.6.1998 “Për rregullimin e pasojave që kanë rrjedhur nga zbatimi i dekretit nr.204, datë 05.06.1992, “Për pasurinë e sindikatave”, mbasi tjetërsimi i pronave të sindikatave nuk mund të bëhet para vitit 2020, në zbatim të Dekretit dhe ligjit.***

Regjistrimi i objektit sipas referencës nr.0006558, është bazuar në legalizimin e tij në zbatim të nenit 77, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 i cili nuk plotëson kushtet urbanistike në zbatim të këtij ligji.

18.1 Rekomandimi: Ti kthehet përgjigje ankuesit që: për sa kohë ju jeni në proces gjyqësor për pronën prej 96 dynym nga ana e KLSH nuk mund të kryhet kufizime për subjektin që ka ndërtuar në pronën që ju pretendoni. f.91-94.

19.Gjetje nga auditimi: Kërkesës nr. 653, datë 24.05.2014 nga qytetari Y.D.

Qytetetari Y.D. pretendon regjistrimin e pasurisë me vendim gjykatë për 328 m² dhe jo sipas vendimit të gjykatës prej 298 m². Regjistrimi është kryer sipas vendimit të gjykatës për 298 m² dhe është në sistem.

19.1. Rekomandimi: Megjithëse Y.D. është sqaruar nga grupi i auditimit, t'i kthehet përgjigje që të përcaktojë sipërfaqen me topograf të licencuar sipas vendimit të gjykatës dhe të aplikojë në ZVRPP Durrës.

B. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenet 37 dhe 144, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, ti kërkohet që të fillojë procedura për dhënien e masave disiplinore, për punonjësit:

1. “Zgjidhje e kontratës së Punës” për:

a. Ish-Regjistruesin B.L.

b. Specialistët K.Gj. dhe D.Gj.

- Për kryerje veprimesh brenda ditë në shkelje të Ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, Aplikim, plotësim e dhënie certifikate pa kartë identiteti dhe pa paraqitur dëshmi trashëgimie dhe pa nënshkrimin përkatës për marrjen e certifikatës në libër.

1. “Vërejtje me shkrim” për:

a. z. A.I. me detyrë jurist,

Për veprime dhe mos veprime në regjistrimet fillestare të kryera në ZK 3385, fshati Shetaj dhe ZK 1204, fshati Bizë për pasuritë sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij projekt vendimi, në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 të ZQRPP “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

2. znj. J.Q. me detyrë juriste në pritje të popullit;

Për veprime të kryera në pritjen e popullit për regjistrimet fillestare të kryera në ZK 3385, fshati Shetaj dhe ZK 1204, fshati Bizë për pasuritë sipas pasqyrave bashkëlidhur këtij projekt vendimi, në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 të ZQRPP “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”.

3. L.H. me detyrë juriste në pritje të popullit;

Për pranim të dokumentacionit në pritjen e popullit për regjistrimet fillestare të kryera.

4. P.B. me detyrë juriste

Për pranim të dokumentacionit me mangësi dhe regjistrimet objekteve me leje legalizimi me mangësi.

5. N.M. me detyrë topograf në zonën urbane;

Për veprime dhe mos veprime në regjistrimet fillestare të kryera në ZK 8518, dhe 8512.

6. B.T. me detyrë topograf në zonën urbane;

Për veprime dhe mos veprime në regjistrimet fillestare të kryera në ZK 8518.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 381/13, datë 10.11.2014 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës:

1. **Z. B.L.me detyrë ish-Regjistrues**
2. **Z. D.Q. me detyrë Specialist**
3. **Z. K.Gj. me detyrë Juriste**

Nga ZVRPP Durrës, me shkresë nr. 9145, prot, datë 09.12.2014, protokolluar në KLSH me nr.381/20 datë 11.12.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Genc Koka, Agim Mandri Hektor Kosova dhe më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT